

SUBJEKTI “ Vllaznimi - DEDA “ sh.p.k
Administrator z. Preng Deda
Adresa : Vore, Tirane
Tel. Mob. 067 20 37 829

RAPORT I PERMBLEDHUR I VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS

(Per aktivitet : Pasurim minerali kromi e depozitim te mases sterile)

Komuna Surroj, Qarku Kukës.

Maj 2014

PERMBAJTJA

Kapitulli I

Pershkrimi i projektit

- 1.1 Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit.
- 1.2 Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristika te tjera te projektit.
- 1.3 Procesi I prodhimit dhe karakteristikat e tij.

Kapitulli II

Pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij.

- 2.1 Popullsia
- 2.2 Flora dhe fauna
- 2.3 Toka, kategoria e saj, gjeologjia dhe gjeomorfologjia
- 2.4 Uji, akuiferet, rruget ujore, brigjet etj.
- 2.5 Ajri, faktoret klimatike, cilesia e ajrit etj.
- 2.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike
- 2.7 Peisazhi dhe topografia
- 2.8 Perdorimet rekreative
- 2.9 Tiparet e tjera mjedisore
- 2.10 Ushtrimi i aktivitetit e lidhja e tij me zona te tjera
- 2.11 Perputhshmeria e aktivitetit me legjislacionin mjedisor

Kapitulli III

Vleresimi i ndikimeve

- 3.1 Ndikimet ne popullsi
- 3.2 Ndikime te dukshme nonat rrethuese e peisazh
- 3.3 Niveli dhe ndikimet e emetimeve gjate fazes se operimit
- 3.4 Niveli dhe ndikimi I zhurmave
- 3.5 Ndikimi ne rruget locale dhe transportit
- 3.6 Ndikimet ne objekte te trashegimise historike, arkitektonike, tiparet arkeologjike e veprave te tjera
- 3.7 Humbja dhe demtimi i habitateve, specieve bimore e shtazore.
- 3.8 Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike. Problemi i ambjentit gjeologjik
- 3.9 Pershkrimi i ndikimeve negative individuale e te grumbulluara, ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare.
- 3.10 Konseguenca te tjera ekologjike.
- 3.11 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise locale, erozionit te tokes etj.
- 3.12 Ndikime te emetimeve kimike e te depozitimeve
- 3.13 Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe burimeve te tjera.
- 3.14 Ndikime ne modelin drenazhues te zones.

- 3.15 Ndryshimet e karakteristikave te tjera hidrografike
- 3.16 Ndikime ne hidrologjine bregdetare dhe te estuarve.
- 3.17 Ndikimet e ndotesve, mbetjeve etj. Ne cilesine e ujit.
- 3.18 Niveli dhe perqendrimi i emetimeve kimike dhe ndikimet e tyre mjedisore.
- 3.19 Lende te veçanta
- 3.20 Aromat sulmuese
- 3.21 Ndikime te tjera klimatike
- 3.22 Ndikime nga trafiku (rruga, hekurudha, ajri, uji etj)qe lidhen me projektin.
- 3.23 Ndikime te lidhura nga grumbullimi e konsumimi i materialeve,ujit, energjise ose burime te tjera si pasoje e projektit.
- 3.24 Ndikime te projekteve te tjera
- 3.25 Ndikime shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara
- 3.26 Ndikime sekondare qe rezultojne nga nderveprimi i ndikimeve te tjera direkte siç u trajtua me siper.

Kapitulli IV

Masat zbatuese

- 4.1 Identifikimi i masave per te zbutur ndikimet negative ne mjedis
 - a- Planifikimi i zones
 - b- Masat teknke
 - c- Masat estetike dhe ekologjike
- 4.2 Vleresim i efektivitetit te pritshem prej masave zbatuese
- 4.3 Masat per sigurine ne pune gjate hapjes dhe shfrytezimit

Kapitulli V

Plani i menaxhimit dhe monitorimit

- 5.1 Plani i menaxhimit
- 5.2 Plani i monitorimit
- 5.3 Pershtatje e projektit me programet e zhvillimit ekonomik te zones
- 5.4 Diskutimi dhe marrje e mendimit nga organet e qeverisjes vendore, etj

Kapitulli VI

Rreziqet e aksidenteve

- 6.1 Rreziqet e aksidenteve dhe masat per parandalimin e tyre.
Marrveshjet ne fuqi qe lidhen me ruajtjen dhe perdorimin e substancave te rrezikshme

Konkluzione e rekomandime

Referenca

1.1 Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit.

a- Te dhena te pergjithshme, vendndodhja, qellimi i projektit

Projekti qe kerkohet te zbatohet nga subjekti juridik “ **Vllaznimi – Deda Import Eksport “ sh.p.k**, do te realizoje ndertimin e nje fabrike, per pasurimin e mineralit te kromit se bashku me venddepozitimin e mases sterile. (dampe). Objekti ndodhet ne zonen administrative te komunes Surroj, Kukes ne anen e majte te rruges per ne fshatin Surroj, rreth 4 km nga rruga kombetare Tirane – Kukes, ne krahun e djathte te saj.

Qellimi

Projekti do te realizoje pasurimin e mineralit te kromit te vendburimit Surroj, qe shfrytezohet nga po kjo kompani, duke arritur te prodhoje koncentrat kromi cilesor per nevoja te tregut te ketij produkti si ne eksport ashtu edhe perpunim ne vend ne Uzinat e ferrokromit ne rast interesi nga keto uzina.

Bazuar ne rezervat minerare, te kesaj miniere dhe kondicionin ekonomik, ne projekt jane saktësuar edhe trupat minerare me kushte te favorshme, me permbajtje te kromit ne xeheror, te pranueshme per nje prodhim konkurrues.

Normalisht ne kushte aktuale kerkesa e larte ne treg per minerale te pasura kromi ka bere qe te pakesohen edhe rezervat, e si rrjedhoje del domosdoshmeri aplikim pasurimi te trupave minerare te varfer.

Referuar eksperiencës bashkekohore ka vite qe aplikohen metoda pasurimi per minerale me permbajtje Cr_2O_3 qe varion nga 14 deri 30 %.

Sasia e rezervave per pasurim eshte parashikuar ne projektin rreth 50 deri 70 mije ton ne vit, me permbajtje mesatare 20 – 22 % Cr_2O_3 .

Theksojme se rezervat ne rajonin e Surroit dhe zonave perreth te cilat mund te shfrytezohen me metode pasurimi jane disa milion ton me cilesine e siperpermendur

Me keto te dhena e sipas natyres mineralogjike te vendburimit fabrika e pasurimit arrin jo vetem tregues optimale tekniko-ekonomike por edhe nje regjim te mire ne drejtim te shkarkimeve ne mjedis.

Skema teknologjike e projektit do te jete ajo e realizuar me pare ne Bulqize, Kalimash e Kraste, por natyrisht me permiresime bashkekohore, duke aplikuar mundesi ndertimi te nje fabrike lehtesisht te zmontueshme ne te ardhmen, ne funksion te kohes se punes etj.

Projekti eshte ne sinkron te plote edhe me strategjine kombetare te zhvillimit te industrise nxjerrëse e perpunuese ne te cilen ben pjese e ze nje peshe te madhe edhe industria e kromit nder me te vjetrat e me tradite ne vendin tone.

Elementet e zgjedhur ne skemen e pasurimit te mineralit te kromit jane bashkekohore, duke permiresuar menyren e shfrytezimit te siperfaqes se tokes, rritur shkallen e mekanizimit, treguesit e pasurimit, etj.

Njekohesisht duke zbatuar skeme optimale te pasurimit me instalim te nje fabrike pasurim te zmontueshme, si faktor pozitiv me tej edhe ne lidhje me problemet mjedisore, per objekte te tilla pas mbylljes se aktivitetit te tyre.

Ky projekt ndikon pozitivisht edhe ne zbutjen e problemeve te mprehta sociale ne kete zone.

